

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga CP Sprus Holdings, S.C.Sp (CP Spruce Holdings, S.C.Sp), me seli të regjistruar në 2 Avenia Charl de Gol, L-1653, Luksemburg, dorëzuar përmes shoqërisë së avokatëve Polenak nga Shkupi, avokat Metodija Velkov nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.11.2024, miratoi këtë:

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin CP Sprus Holdings, S.C.Sp, (CP Spruce Holdings, S.C.Sp), me seli të regjistruar në 2 Avenia Charl de Gol, L-1653, Luksemburg synon të marrë kontrollin mbi Vantiv Helt LLC., me seli në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Vantiv Meksiko LLC, me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA,, Gambro Rinal Produkts, Inc. me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA, RTS Worldvaid Holdings Inc., me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Vantiv Holding B.V. me seli të regjistruar në Kobaltveg 49, 3542 CE Utreht, Holandë, Vantiv Helt GmbH, me seli të regjistruar në Thurgauerstrasse 130 Glatpark (Opfikon), Cirihi 8152, Zvicër, dhe Vantiv Holding Limited, me seli të regjistruar në katin e 4-të, St Paul's Gejt, 22-24 Nju Strit, St Helier, Xhersi, JE1 4TR, Ishujt e Kanalit, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 15.10.2024, dhe plotësuar më 17.10.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka pranuar një njoftim për përqendrim nga CP Sprus Holdings, S.C.Sp, me seli të regjistruar në 2 Avenia Charl de Gol, L-1653, Luksemburg, me të cilin CP Sprus Holdings, S.C.Sp synon të marrë kontrollin mbi Vantiv Helt LLC., me seli në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Vantiv Meksiko LLC, me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA,, Gambro Rinal Produkts, Inc. me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej,

Dijrfield, IL, 60015, SHBA, RTS Worldvaid Holdings Inc., me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej, Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Vantiv Holding B.V. me seli të regjistruar në Kobaltveg 49, 3542 CE Utreht, Holandë, Vantiv Helt GmbH, me seli të regjistruar në Thurgauerstrasse 130 Glatpark (Opfikon), Cirih 8152, Zvicër, dhe Vantiv Holding Limited, me seli të regjistruar në katin e 4-të, St Paul's Gejt, 22-24 Nju Strit, St Helier, Xhersi, JE1 4TR, Ishujt e Kanalit.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

CP Sprus Holdings, S.C.Sp është një shoqëri me qëllim të veçantë, e përfaqësuar nga partneri i saj i përgjithshëm CP VIII Paricipations S.a.r.l., një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar nga Luksemburgu me seli të regjistruar në 2 Avenia Charl de Gol, L-1653, Luksemburg, e cila kontrollohet indirekt nga shoqëritë e varura të Karlajl Group Inc(Carlisle Group Inc. së bashku me fondet e kontrolluara dhe shoqëritë e varura më poshtë si „**Karlajl**“)

Karlajl është një menaxher global i aseteve alternative, që menaxhon fonde që investojnë globalisht në tre disiplina investimi:

Kapitali privat global (duke përfshirë kapitalin privat të korporatave, fondet e pasurive të paluajtshme dhe burimeve natyrore);

Kredia globale (duke përfshirë kreditë likuide, kreditë jo likuide dhe kreditë e mjeteve reale); dhe

Zgjidhjet e investimeve (programi i fondeve të kapitalit privat, të cilat përfshijnë fondet parësore, aktivitetet dytësore dhe të lidhura me bashkë investimin).

Karlajl ka tre shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime informatike DEPT TECHNOLOXHI MACEDONIA SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar: rr. Maksim Gorki nr.13-kati 3/B.C. Nastel, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, NUAS 6594131 dhe aktiviteti prioritar 62.01 – Programimi kompjuterik (“**DEPT TECHNOLOGXHI MAQEDONIA SHPKNJP Shkup**”).
- SHOQËRIA për tregti dhe shërbime HSO GLOBAL SERVICES SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Maksim Gorki nr. 13-1-4/ndr..1 K.K2, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, NUAS 7311346 dhe aktiviteti prioritar 62.02 – Aktiviteti i konsulencës kompjuterike (“**HSO GLOBAL SERVICES SHPKNJP Shkup**”).

Vantiv është divizioni i kujdesit për veshkat e Bakster Interneshnl Inc. („**Bakster**“). Vantiv është kryesisht aktiv në furnizimin e produkteve të terapisë zëvendësuese të veshkave (“**RRT**”).

Produktet RRT përdoren për të trajtuar pacientët që vuajnë nga sëmundja e veshkave në fazën përfundimtare („**ESRD**“), e cila është forma më e rëndë e dështimit të veshkave. Dështimi i veshkave ndodh kur veshkat nuk filtrojnë gjakun, duke rezultuar në depozitim të mbetjeve dhe toksinave në qarkullimin e gjakut.

Aktivitetet e Vantiv kanë dy ndarje kryesore:

Terapitë kronike, të përbëra nga produkte portofoli për dializë peritoneale („**PD**“) dhe hemodializë („**HD**“) dhe

Terapitë akute („**AT**“) që përbëhen nga terapia e vazhdueshme zëvendësuese renale („**CRRT**“) dhe terapi të tjera mbështetëse të organeve të përdorura në njësinë e kujdesit intensiv („**ICU**“).

Për plotësinë, "dializa" i referohet një trajtimi që synon të zëvendësojë aspektet e funksionit të veshkave tek njerëzit, funksioni i veshkave të të cilëve po dështon (HD dhe PD janë dy modalitete të dializës).

Vantiv do të përbëhet nga shoqëritë e mëposhtme:

- **Vantiv Helt LLC** - një shoqëri holding me aktivitet të kufizuar operativ.
- **Vantiv Meksico LLC** - një shoqëri holding për subjektet operative në Meksikë.
- **Gambro Rinal Produkts, Inc**- një shoqëri holding e pronësisë intelektuale.
- **RTS Worldvaid Holdings Inc.** - një shoqëri holding për subjektet që punojnë me klinikat e dializës jashtë SBA-së dhe operacionet teknike në SHBA.
- **Vantiv Holding B.V.** – një shoqëri holding për subjekte operative dhe jo-operuese jashtë SHBA.
- **Vantiv Helt GmbH**, qëllimi i së cilës është të prodhojë, zhvillojë, importojë, eksportojë, blejë, shesë, licencojë, tregtojë, shpërndajë, ofrojë, riparojë, instalojë, programojë dhe mbajë në emër dhe në llogari të tij, ose si përfaqësues shitjesh ose komision agent/një tregtar i produkteve të kujdesit shëndetësor, farmaceutikëve, pajisjeve mjekësore dhe terapive, produkteve dhe shërbimeve përkatëse.
- **Vantiv Holding Limited**, është një shoqëri holding pa aktivitet operativ.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës

efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска